



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Fakulteti Ekonomik

Pranvera Dalloshi

**Financimi i bizneseve përmes kredive bankare dhe
ndikimi i tij në vlerën e investimeve në Kosovë,
analizë krahasuese me disa vende të Evropës
Juglindore**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:
Myrvete Badivuku-Pantina

Prishtinë, 2018



University of Prishtina "Hasans Prishtina"
Faculty of Economic

Pranvera Dalloshi

**Financing of businesses through bank loans and its
impact on the value of investments in Kosovo,
comparative analysis with some Southeastern
European countries**

DOCTORAL THESIS

Prishtinë, 2018

ABSTRAKTI

Me riorganizimin e ekonomive shtetërore, pra pas kalimit të shteteve nga ekonomia e komanduar në ekonominë e tregut, ato nuk kanë informacione për investuesit potencial, idetë dhe aftësitë e tyre financiare për të ndërmarrë një investim i cili do të ishte profitabil dhe efektiv për rritjen ekonomike. Prandaj, mendohet se institucionet financiare nëpërmjet vlerësimit të ideve (me rastin e aprovimit të kredisë) dhe ofrimit të mjeteve financiare, janë ato të cilët mundësojnë që investuesit potencial ti realizojnë projektet e tyre.

Siç tregon praktika, sektori financiar kryen disa funksione, por mendohet se ai i cili afekton më së shumti rritjen ekonomike është funksioni i alokimit të mjeteve (kursimeve të depozitorëve) te investorët potencial. Mirëpo kryerja e këtij funksioni vështirësohet për shkak të faktit se tregjet janë jo perfekte dhe ato shoqërohen me probleme të ndryshme siç janë: informatat asimetrike apo “lemons problem”, problemet e agjencisë, kostot e transaksionit etj., të cilat vështirësojnë lidhjen financim-investime, apo lidhjen e sektorit financiar me atë privat. Në këtë kontekst ky hulumtimit bazohet në faktin se qasja në financa është shumë e rëndësishme për bizneset, në mënyrë që ato të rriten qoftë duke investuar në asete produktive, qoftë duke gjetur mënyra më inovative të operimit, pasi që disponueshmëria e burimeve të financimit konsiderohet si pikë fillestare e vendimit për të investuar.

Duke kombinuar faktorët makroekonomik dhe ato mikroekonomik ky punim sjell një qasje të re të matjes së ndikimit të zhvillimit të sektorit bankar në financimin e bizneseve me kredi në disa vende të Evropës Juglindore. Kështu, ky hulumtim fokusohet të jap përgjigje nëse sistemi financiar i një vendi jep kontribut në rritjen e normës së investimeve, e matur kjo në mënyrë direkte, pra duke investuar në asete fikse. Ky hulumtim fokusohet në sektorin bankar si burim i financimit të jashtëm për bizneset, kjo për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit të tregjeve të kapitalit, mos zhvillimi i të cilit ndikohet nga struktura e organizimit të bizneseve në Kosovë e cilat kryesisht përbehet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. E veçanta e këtij hulumtimi është analizimi i ndikimit që ka zhvillimi i sektorit bankar në probabilitetin që një biznes të ketë kredi, pra analizohet ana e kërkesës si edhe ana e ofertës së kredive, pasi që sipas disa studimeve sektori bankar nuk është çdo herë i gatshëm t’u ofroj kredi të gjitha llojeve të bizneseve apo edhe sektorëve

të caktuar, kjo veçanërisht vlen për vendet në tranzicion për shkak të disa karakteristikave makroekonomike ku më i rëndësishmi është sistemi ligjor i cili duhet të jetë në funksion të mbrojtjes së të drejtave të kreditorëve.

Ky hulumtim përdor të dhënat të institucioneve kredibile siç janë të dhënat nga anketat e zhvilluara nga EBRD në bashkëpunim me Bankën Botërore (BEEPS), Fondit Monetar Ndërkombëtar, si dhe të dhënat e pasqyrave financiare të audituara të bizneseve të mëdha në Kosovë të publikuara nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Për të testuar hipotezat janë përdorur modele të cilat janë të përshtatshme për të dhëna të ndërtuara në mënyre hierarkike. Gjithashtu, për të testuar efektin që kanë burimet e financimit përmes kredive bankare në vlerën e investimeve të reja të bizneseve është përdorur modeli i regresionit linear dhe modeli Logit. Të dhënat nga këto modele mbështesin hipotezën se rritja e kreditimit nga bankat ka efekt pozitiv në vlerën e investimeve të ndërmarra nga ana e bizneseve.

Fjalët kyçe: sektori bankar, investimet në asete fikse, qasaj në financa

ABSTRACT

The transition period, from controlled economies to the market economy, has affected the states information on their potential investors, their ideas and financial capabilities to undertake a profitable investment, which would be effective for economic growth. Therefore, it is thought that financial institutions through the evaluation of ideas (in the case of credit approval) and through providing of financial sources are the ones that enable the profitable projects.

The financial sector perform many functions, but it is thought that the one that mostly affect the economic growth is the function of allocating the assets (depositor savings) to potential investors. But this function is hampered by non-perfect market problems like asymmetric information, or "lemons problem", agency problems, transaction costs, etc., which hinder the financing-investment link or the relationship between the financial sector and the private sector. In this context, this research is undertaken based on the fact that access to finance is very important for businesses, considering that their growth comes either by investing in productive assets or by finding innovative ways of operating. Since the financial sources and investment opportunities are the starting point of the decision to invest, this research focuses on answering whether a country's financial system contributes to the growth of firm's investment.

By combining microeconomic and macroeconomic factors, this research present a new approach of assessing the impact of the banking sector development on the financing of businesses with loans in some SEE countries. The focuses on banking sector is due to the fact that in SEE countries the capital markets are underdeveloped, the development of which is affected by the structure of business, which is mainly composed of small and medium enterprises. The probability of the business to have a loan with a commercial bank is assessed taking in consideration the firm's characteristics and banking sector development indicators, thus considering the supply and demand side. This because according to some studies, the banking sector is not always willing to provide loans to all types of businesses or even certain sector. This is particularly true for transition countries due to some macroeconomic characteristics where the most important is the legal system, which should be in the function of protecting creditor rights.

This research uses the data derived from credible institutions such as the data from surveys conducted by the EBRD in co-operation with the World Bank (BEEPS), the International Monetary Fund, as well as the audited financial statements of large businesses in Kosovo published by the Kosovo Council for Financial Reporting. In order to conclude about the impact of banking sector development on increasing the firm external financing, appropriate models for hierarchically structured data are used. In addition, the linear regression model and the logit model have been used to test the impact of external funds in the value of new fixed assets. The results support the hypothesis that bank sources have a positive impact on the value of new fixed assets.

Key words: banking sector, fixed assets investments, access to finance